

## FTESË PËR APLIKIM PËR GRANTE

### GRANTE PËR ADRESIMIN E ÇËSHTJEVE TË DIGJITALIZIMIT DHE NDRYSHIMEVE KLIMATIKE NË PERIME/SERRË DHE PEMËTARI (DREDHËZ/MJEDËR)

#### Rreth projektit

Organizata “Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës” (IADK), është duke zbatuar projektin “Përmirësimi i punësimit dhe mundësive për gjenerim të të ardhurave në zonat rurale të Kosovës”, projekt tre-vjeçar (2023-2025), i përkrahur nga Donatori “Bread for the World” nga Gjermania dhe bashkëfinancuar nga komunat partnere. Përmes aktiviteteve të projektit, synojmë të promovojmë teknologji të reja që ndihmojnë në digjitalizimin e aktiviteteve në bujqësi, pra përmes granteve dhe trajnimeve, synojmë që të promovoj dhe zbatoj intervenime të ndryshme që do të ju mundësoj fermerëve që të digjitalizojnë aktivitetet në bujqësi dhe të adresojnë çështjet e ndryshimeve klimatike, si në aspektin e zvogëlimit të efektit të dëmshëm që vije nga bujqësia, po ashtu në përshtatjen e praktikave të tyre krahas ndryshimeve klimatike. Prandaj, gjatë vitit 2025, IADK përmes projektit të sajë synon të mbështes fermerët në sektorin e hortikulturës (pemë dhe perime) me ide dhe aktivitete të përshtatshme për digjitalizim dhe ndryshime klimatike.

#### Kush ka të drejtë aplikimi?

Të gjithë fermerët që merren me sektorin e hortikulturës (perime & pemë) sipas kriterëve dhe kostove të pranueshme.

#### Fermerët nga cilat komuna do të mbështeten?

✓ Vushtrri	✓ Mitrovicë	✓ Skënderaj
✓ Drenas	✓ Podujevë	✓ Suharekë

#### Kushtet që duhet plotësuar për aplikim

- Aplikuesi/ja duhet të jetë nga një prej komunave të lartëcekura si dhe investimet duhet të bëhen brenda teritorit të komunës së lartëcekur.
- Aplikuesi/ja të jetë përgjegjës kryesor në menaxhimin e aktiviteteve ditore në fermë, inkurajohen aplikuesit/fermerët e rinj (18-35 vjeç) dhe jo vetëm.
- Aplikuesi/ja duhet të jetë aktivë në zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme në bujqësi, specifikiisht në kultivimin e perimeve në serra dhe pemëve (mjedër, dredhëz) sipas kriterëve dhe sipërfaqeve në kostot e pranueshme për financim.
- Aplikuesi/ja të ketë burime të mjaftueshme si infrastrukturë dhe njerëzore në zbatimin e aktiviteteve të projektit dhe të ketë gatishmëri në realizimin e projektit – grantit sipas udhëzimeve të IADK-së.
- Aplikuesi/ja do të diskualifikohet nëse dëshmohet se ka përfituar grant të ngjashëm në 3 vitet e fundit, grant nga donatorë tjetër, nga MBPZHR dhe/ose Komuna.

#### Dokumentet për aplikim

- Aplikacionet mund të merren në zyrat e IADK-së dhe zyrat komunale për bujqësi në Vushtrri, Mitrovicë, Skënderaj, Drenas, Suharekë dhe Podujevë. Gjithashtu, forma e aplikacionit mund të kërkohet përmes e-mail duke kontaktuar [sylejmanbunjaku@hotmail.com](mailto:sylejmanbunjaku@hotmail.com) dhe [hajraegzona@gmail.com](mailto:hajraegzona@gmail.com).
- Aplikacioni duhet të përmbaj të gjithë informacionet e kërkuar, duhet të dorëzohet në zyrat e IADK-së apo zyrat për bujqësi në komunat përkatëse, si dhe mund të dërgohet edhe në formën elektronike në e-mail adresën: [sylejmanbunjaku@hotmail.com](mailto:sylejmanbunjaku@hotmail.com) dhe [hajraegzona@gmail.com](mailto:hajraegzona@gmail.com).
- Krahas aplikacionit, aplikuesi/ja duhet të dorëzojnë edhe: [https://podujeve.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/03/Formulari-per-aplikim-per-grante\\_2025.docx](https://podujeve.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/03/Formulari-per-aplikim-per-grante_2025.docx)
  - a. Kopje të letërnjoftimit të aplikuesit
  - b. Kopje të certifikatës familjare të aplikuesit
  - c. Certifikatën e NIF (nëse e posedoni)
- Aplikacioni me dokumentet tjera të kërkuara duhet të dorëzohet jo më vonë se data 17.03.2025 deri në ora 16:00.
- Për informacione shtesë mund të na kontaktoni në numrin e telefoni +383 44 412 475 nga ora 8:00 – 16:00.

## Mbështetja financiare

- Granti i kërkuar nga IADK, duhet të jetë sipas ndarjeve të mëposhtme:
  - a. Vlera e mbështetur nga projekti është deri: 600.00 Euro
  - b. Çdo vlerë tjetër mbi 600.00 Euro, do të përfshijë bashkëfinancimin e fermerit.

## Kostot e pranueshme për financim

Aktivitetet/kostot të cilët mund të financohen në kuadër të projektit:

### I. GRANTE PËR DIGJITALIZIM TË AKTIVITETEVE NË PERIME – SERRË

1. **Furnizimi dhe instalimi i sistemit të ujitjes së kontrolluar nga telefoni i mençur për serra me sipërfaqe minimale 500m<sup>2</sup>.**
  - kostoja totale e investimit të llogaritur është 984.00 €, përmes grantit IADK do mbuloj shumën 600 €, ndërsa përfituesi/fermeri do të bashkëfinancoj në vlerën 384.00 €
2. **Furnizimi dhe montimi i motorëve për hapje të dy dritareve anësore të serres - manual përmes ndërprerësit, serra duhet të ketë sipërfaqe minimale 500m<sup>2</sup>.**
  - kostoja totale e investimit të llogaritur është 880.00 €, përmes grantit IADK do të mbulojë shumën 600 €, ndërsa përfituesi/fermeri do të bashkëfinancojë në vlerën 280.00 €

### II. GRANTE PËR ADRESIMIN E NDRYSHIMEVE KLIMATIKE NË PERIME – SERRË

1. **Furnizimi me rrjeta për hijezim të serrave me sipërfaqe 500m<sup>2</sup> e më tepër.**
  - kostoja totale e investimit të llogaritur për 2000 m<sup>2</sup> serrë është 600.00 €, por fermerët mund të aplikojnë për mbulim të serrave me sipërfaqe jo më të vogla se 500m<sup>2</sup>.
2. **Furnizimi me rezervuar plastik 3000L dhe elemente përcjellëse për grumbullim të ujit të shiut nga serra, për serrat jo më të vogla se 500m<sup>2</sup>**
  - Kostoja totale e investimit të llogaritur është 600.00 €, përmes grantit IADK do të mbulojë këtë shumë, gjdo vlerë mbi këtë shumë për kapacitet shtesë të rezervuarit apo elementeve shtesë do të bashkëfinancohet nga përfituesi/fermeri.

### III. GRANTE PËR ADRESIMIN E NDRYSHIMEVE KLIMATIKE NË PEMËTARI – MJEDËR DHE DREDHËZ

1. **Furnizimi dhe montimi i serrës me konstruksion të lehtë nga metali i zingtuar për mbulim dredhëzave me sipërfaqe 150m<sup>2</sup>.**
  - kostoja totale e investimit të llogaritur për këtë sipërfaqe është 810.00 €, përmes grantit IADK do të mbulojë shumën 600 €, ndërsa përfituesi/fermeri do të bashkëfinancojë në vlerën 210.00 €.
2. **Furnizimi dhe montimi i kornizave të lehta nga metali i zingtuar për vendosjen e rrjetave për hijezimin e mjedrave.**
  - kostoja totale e investimit të llogaritur është 600.00 € për fermerë dhe do të mbulohet përmes grantit të IADK-së. Përtej kësaj vlere shtesë do të bashkëfinancohet nga përfituesi/fermeri.